



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202301124/9

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**Lënda:** Rekomandim për intensifikimin e punës për garantimin e të drejtës së jetës dhe shëndetit të qytetarëve

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**INSPEKTORATIT SHTETËROR SHËNDETËSOR**

*Të nderuar,*

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij kushtetues, për promovimin, mbrojtjen dhe parandalimin e shkeljes së të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, i ka kushtuar dhe i kushton një vëmendje të veçantë, të drejtës së shëndetit dhe kujdesit shëndetësor, si një aspekt i rëndësishëm që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e jetës së individëve dhe komuniteteve të gjera. E drejta e njeriut për kujdesin e duhur mjekësor dhe për jetë të shëndetshme është një e drejtë themelore e njohur në aktet ndërkombëtare që garantojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Siç tashmë jeni informuar, pasi jemi njohur me problematikën e mjekëve të huaj të cilët ushtrojnë profesionin në Shqipëri, në klinikat apo spitalet private, por që nuk rezultojnë të regjistruar apo liçencuar, sipas legjislacionit në fuqi, kemi nisur më datë 01.12.2023 një hetim administrativ për këtë rast, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Për qëllime të realizimit të vlerësimit për situatën aktuale të ushtrimit të profesionit nga mjekë të huaj të paliçencuar, si dhe për të kuptuar se cilët janë mekanizmat që sigurojnë monitorimin e këtij fenomeni, i jemi drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<sup>1</sup>, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor<sup>2</sup> si dhe Urdhrit të Mjekut<sup>3</sup>.

Ministria e Shëndetësisë, me shkresën nr. 277/1, datë 31.01.2024 na ka informuar lidhur me kompetencat e Urdhrit të Mjekëve dhe Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, si dhe mbi kriteret për liçencimin e shtetasve të huaj që ushtrojnë profesionin e mjekut, por nuk na ka informuar nëse me publikimin e problematikës në fjalë ka pasur vëmendje të veçantë apo masa të përshtatshme për monitorimin e situatës.

<sup>1</sup> Shkresë nr. K1/I84-4, datë 12.01.2024 e Avokatit të Popullit drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

<sup>2</sup> Shkresat e Avokatit të Popullit nr. K1/I84-3, datë 12.01.2024 dhe nr. K1/I84-7, datë 05.02.2024 drejtuar Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor

<sup>3</sup> Shkresë nr. K1/I84-2, datë 12.01.2024 e Avokatit të Popullit drejtuar Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), me shkresën nr. 285/1, datë 12.02.2024 na ka informuar se ky organ kryen inspektime të programuara të bazuara në programin vjetor me tematika specifike dhe planet mujore të inspektimeve, si dhe inspektime jashtë programit, të cilat mund të autorizohen edhe në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga të tretët, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nga një subjekt. Në përgjigje të pyetjes sonë, nëse ka *ekipe të specializuara të inspektorëve të shëndetit që janë të përgatitur dhe të dedikuara për të monitoruar në vazhdimësi mënyrën e ushtrimit të profesionit nga mjekët e huaj, si dhe për të identifikuar dhe parandaluar ushtrimin e profesionit nga mjekët e palicencuar në institucionet shëndetësore private* ky organ i përgjigjet se inspektimi kryhet nga e gjithë trupa inspektuese e ISHSH. Megjithatë, ISHSH na informon se ka vendosur gjithsej 24 masa administrative për raste kur është konstatuar ushtrim aktiviteti pa licencë, por nuk përcillet informacion konkret sa nga këto raste i përkasin ushtrimit të aktivitetit nga mjekët e huaj të palicencuar, pasi, ISHSH shprehet se nuk kryen klasifikim të gjobave në shtetas shqiptarë apo të huaj. Megjithatë, Avokati i Popullit vlerëson se edhe nisur i vogël i masave administrative, një e dhënë e tillë mund të nxirrej edhe nga Inspektorati lehtësisht nga përmbajtja e këtyre 24 masave të dhëna.

Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë, me shkresën nr. 07/1, datë 29.01.2024 na ka informuar mbi kriteret e parashikuara nga ligji si dhe mbi procedurën që ndiqet për liçencimin e mjekëve të huaj që ushtrojnë profesionin në Shqipëri, por duke theksuar se ky organ nuk vepron dhe nuk gjykon mjekët që nuk janë të regjistruar, anëtarësuar apo liçencuar prej tyre.

\*\*\*

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson të theksojë se, duke nisur nga rëndësia që ka shërbimi i dhënë nga personeli mjekësor, por edhe implikimet e mundshme në jetën e qytetarëve, profesioni i mjekut është një profesion i rregulluar, pikërisht me qëllimin e mbrojtjes së pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të mjekut.

E drejta e shëndetit është një nga të drejtat themelore, e lidhur drejtpërdrejt me të drejtën e jetës. Evolucionin drejt përcaktimit të shëndetit si çështje sociale ose publike çoi në themelimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) në vitin 1946. Me themelimin e OBSH-së, për herë të parë e drejta për shëndet u njoh ndërkombëtarisht. Statuti i OBSH-së pohon se "gëzimi i standardit më të lartë të arritshëm të shëndetit është një nga të drejtat themelore të çdo qenieje njerëzore pa dallim race, feje, besimi politik, gjendje ekonomike ose sociale". Nga ana tjetër, e drejta për jetë lidhet ngushtë me të drejtën për shëndetin e qytetarëve, pasi shërbimi shëndetësor jocalësor, apo i pakontrolluar, apo jashtë standardeve ndërkombëtare, mund të çënojë rrjedhimisht jetën e njeriut.

Nga vlerësimi i kuadrit ligjor në fuqi që rregullon mënyrën e liçencimit të mjekëve të huaj që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë, vërejmë se ligji nr. 123/2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë" përcakton se asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e mjekut, në sistemin e kujdesit shëndetësor publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Mjekëve dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga ky organizëm, duke përcaktuar edhe dokumentacionin përkatës (neni 5, pika 3):

3. Çdo mjek, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri, apo i atashuar në një institucion shëndetësor ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente:

a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;

b) certifikatën e mirësjelljes (Good Standing Certificate) nga Urdhri/dhoma apo shoqata e mjekëve të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;

*c) njësimin (konvalidimin) e diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj;*

*ç) një rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Mjekëve;*

*d) dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe, të vërtetuar nga një autoritet i licencuar nga shteti. Mjeku jorezident detyrimisht punon me përkthyes.*

Megjithatë, në vlerësim të përgjigjeve të përcjella nga organet e sipërcituara, por edhe të paketës ligjore në fuqi, konstatohet se nuk ka një kuadër të konsoliduar nënligjor, administrativ apo metodologjik për identifikimin e rasteve kur shtetasit e huaj ushtrojnë profesionin e mjekut pranë institucioneve shëndetësore private, në mënyrë të paautorizuar.

Nga ana tjetër konstatohet po kështu që nuk ka një vëmendje të posaçme lidhur me këtë problematikë mjaft shqetësuese. Mbiëkqyrja rezulton të jetë fragmentare, dhe koordinimi ndërinstitutional është i pamjaftueshëm. Organet shtetërore duhet të kenë një metodologji të posaçme të monitorimit të rasteve të mjekëve të palicencuar, të cilat mund të identifikohen lehtësisht nëpërmjet kanaleve zyrtare apo jozyrtare të komunikimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor me publikun. Nga një monitorim i thjeshtë në kuadër të këtij hetimi administrativ u konstatua se në mënyrë mjaft intensive, pothuajse të përditshme, institucionet e kujesit shëndetësor privat reklamojnë mjekë të huaj të specialiteteve dhe prejardhjeve të ndryshme, duke informuar publikisht për datat e konsultave apo ndërhyrjeve që ata kryejnë (në rastet kur paraqiten me kohë të pjesshme). Ky burim informacioni publik, duhet të shërbejë si indicie për organet inspektuese dhe ato ligjzbatuese, për të shënjestruar rastet e reklamimit të ushtrimit të aktivitetit në mënyrë të kundraligjshme, dhe për të marrë masat përkatëse konform legjislacionit në fuqi.

Nga vlerësimi i përgjigjes së ISHSH kuptohet se verifikimi i dokumentacionit të mjekëve të huaj që ushtrojnë profesionin pranë institucioneve shëndetësore është një nga çështjet që verifikohet në institucionet objekt inspektimi të planifikuar nga ky organ. Për këtë arsye, Avokati i Popullit konstaton se kemi të bëjmë me një vlerësim sipërfaqësor të situatës. Organet shtetërore nuk mund të mjaftohen me verifikimin e plotësisht të kriterëve formale dhe ngushtësisht ligjore, aq më tepër në kushtet kur, siç informohemi nga ISHSH inspektimet e planifikuara njoftohen 7 ditë para mbi datat kur do të kryhet inspektimi si dhe objektin e inspektimit, çka krijon hapësira për marrjen e masave paraprake nga subjektet që do të inspektohen. Organet shtetërore, veçanërisht ato që ushtrojnë funksione monitorimi, inspektimi apo kontrolli duhet t'a shtrijnë dhe t'a përshtasin veprimtarinë e tyre kundrejt realizimit të qëllimit thelbësor në frymën e ligjit, që është garantimi i standardeve më të larta të kujdesit shëndetësor.

Ushtrimi i profesionit mjekësor nga mjekë të huaj në mënyrë të paautorizuar apo pa licencë ka disa implikime serioze, siç janë rreziku për sigurinë e pacientëve, mungesa e përgjegjësisë ligjore apo edhe besueshmëria e sektorit shëndetësor. Rreziku për sigurinë e pacientëve nga mjekët e paautorizuar vjen si rezultat i mungesës së vlerësimit dhe monitorimit të rregullt të aftësive të tyre profesionale. Mjekët e paautorizuar nuk i nënshtrohen proceseve të vlerësimit nga organet e licensimit për të vlerësuar aftësitë e tyre profesionale, çka mund të rezultojë në mosnjohjen e praktikave dhe standardave të duhura mjekësore. Pa një sistem efektiv të monitorimit, mjekët e paautorizuar mund të praktikojnë profesionin për një kohë të gjatë pa qenë nën vëzhgim, dhe kjo mund të krijojë hapësirë për praktika të gabuara apo edhe mjekim të pakujdesshëm. Nga ana tjetër, mjekët pa licencë nuk janë të ekspozuar ndaj përgjegjësisë ligjore. Pacientët që trajtohen nga mjekë të paautorizuar mund të jenë të privuar nga mbrojtja ligjore dhe kompensimi në rast të dëmeve shëndetësore. Kjo situatë i lë ata të pambrojtur në rast të shkeljeve të të drejtave të tyre shëndetësore. Një tjetër implikim që buron nga mungesa

e një metodologjie apo veprimtarie të qartë administrative që shënjestron rastet e ushtrimit të profesionit në mënyrë të palicencuar është edhe ulja e besueshmërisë në sistemin shëndetësor. Pasiguria mbi statusin ligjor dhe cilësinë e mjekëve të huaj pa licencë mund të ndikojë në vendimet e pacientëve për të kërkuar kujdes shëndetësor. Në rastet kur pacientët ndihen të pasigurt, ata mund të kërkojnë mundësi alternative për trajtim. Por, praktikrat e mjekëve të paautorizuar mund të dëmtojnë edhe imazhin e profesionistëve të licencuar dhe institucioneve shëndetësore të vendit. Publiku mund të ndihet më pak i sigurt kundrejt sistemit shëndetësor në tërësi. Kur publiku humbet besimin në sistemin shëndetësor, kjo mund të shkaktojë një krizë besimi që mund të ketë pasoja afatgjata për sistemin shëndetësor.

E drejta e shëndetit është afirmuar në nivel ndërkombëtar me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, neni 25, që në vitin 1948. Në të, mes të tjerash, thuhet se “*Çdo njeri ka të drejtë për një standard jete të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij*”. Preambula e kushtetutës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë gjithashtu konfirmon se është e drejtë themelore e çdo njeriu të gëzojë standartet më të larta të arritshme të shëndetit. E pandarë nga e drejta e shëndetit është e drejta e kushteve themelore të shëndetit dhe të kujdesit shëndetësor. Të drejtat e njeriut janë të ndërvarura, të pandashme dhe të ndërthurura. Kjo do të thotë se shkëlja e të drejtës së shëndetit shpesh, mund të pengojë gëzimin e të drejtave të tjera të njeriut si të drejtën për arsim, të drejtën për punë ose anasjelltas. Ndërmjet të drejtave kryesore të shtetasve të sanksionuar në Kushtetutë dhe në konventa ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë është e drejta për të gëzuar nga shteti, në mënyrë të barabartë, të drejtën për kujdes shëndetësor, si dhe sigurim shëndetësor, sipas procedurës së caktuar në ligj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë pohon rëndësinë e drejtës për kujdes shëndetësor nga shteti dhe thekson përgjegjësinë e shtetit për të krijuar dhe mbajtur sisteme shëndetësore efektive dhe të drejta për shtetasit. Neni 55 i Kushtetutës<sup>4</sup> nen shërben si një bazë ligjore për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit shëndetësor në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe nevojat e qytetarëve.

Avokati i Popullit vlerëson se parimi mbi të cilin duhet të mbështet funksionimi i kujdesit shëndetësor është cilësia e shërbimit dhe efënca duke garantuar sigurinë e pacientit dhe paanësinë. Në këtë mënyrë zbatohet një tjetër standard ndërkombëtar i përfaqur nga legjislacioni i brendshëm që e ka filluesën që në Deklaratën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, si dhe ka konfirmuar objektivin social kushtetues sipas të cilit shteti synon standartin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”, si dhe në vijim të neneve 2 dhe 21/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar,

### **REKOMANDOJMË:**

*Përmirësimin e cilësisë së ushtrimit të funksionit mbikëqyrës e monitorues nëpërmjet:*

*1. Intensifikimit të inspektimeve të dedikuara ngushtësisht për identifikimin e rasteve të ushtrimit të paautorizuar të profesionit nga mjekët e huaj në Republikën e Shqipërisë;*

---

<sup>4</sup> Neni 55

1. Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.

2. Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.

2. Evidentimit në formë statistikore të rasteve të mjekëve të huaj që ushtrojnë profesionin pa liçencë;

3. Organizimit të fushatave ndërgjegjësuese për rëndësinë e shërbimeve mjekësore të liçencuara.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se:

*“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,*

lutemi, pas shqyrtimit, të n’a vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**K O M I S I O N E R E**

**Vilma SHURDHA**